



---

**VENDIM**  
**Nr.98 Datë 07.12.2010**

**PËR**  
**PËRCAKTIMIN E TARIFËS TË TRANSMETIMIT TË ENERGJISË**  
**ELEKTRIKE NGA OST SH.A PER PERIUDHEN 1 JANAR – 31**  
**DHJETOR 2011**

Në mbështetje të neneve 8, pika 2, gërma “b”, 9, 26 pika 1, 27 dhe 28 të Ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neneve 15, 20 dhe 21 të Rregullave të Praktikës dhe Proçedurave të ERE-s, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.21, datë 18.03.2009, Vendimit nr.59, datë 29.12.2005, “Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës së transmetimit të energjisë elektrike”, vendimit nr.64 datë 13.09.2010, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, “Për fillimin e proçedurave për përcaktimin e tarifës të transmetimit të energjisë elektrike nga OST sh.a për vitin 2011” Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 07.12.2010, pasi shqyrtoi aplikimin e OST sh.a për përcaktimin e tarifës të transmetimit të energjisë elektrike per vitin 2011, si dhe relacionin e Grupit te Punes te ERE-s,

**Vendosi :**

1. Tarifa e transmetimit të energjisë elektrike për OST sh.a për periudhen 1 Janar – 31 Dhjetor 2011 do te jete **0.60 leke/kWh.**
2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e OST sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.  
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

